P O E Z I

VDES ME TRËNDAFILIN

ELIFE LUZHA

ص ص ص

PRISHTINË 2007

PARATHËNIE

Duhet thënë që në fillim se libri "Vdes me trëndafilin" i poetes Elife Luzha është një libër i padjallëzuar. Është libër i tillë sepse këto poezi i krijon pasioni i vazhdueshëm dhe sublim i saj për Kosovën, familjen e shoqërinë, për jetën shqiptare në përgjithësi, krahas intimes të cilat janë alfa dhe omega e udhës së saj jetësore plot krajata. E terrorizuar qysh e re, ajo nuk ka edhe si t'i ikë këtij mozaiku motivor. Si një vash e futur herët në dhembjen e tokës së saj, doemos e krijon Mbi-Unin i cili tërë jetën do ta udhëheq nga Kosova (poezia "kthimi"). Poetja nuk e reflekton urrejtjen e as

inatin, por e reflekton revoltën, sepse atëdheu i saj padrejtësisht vuante robërinë. Përkundrazi ajo udhëhiqet nga dashuria, nga dashuria për vendëlindjen, fëmijët dhe jetën në tërësi, por asnjëhere pa e gënjyer veten se liria mund të vie një natë nga një derë që nuk e sheh kush. Me urtësi ajo shtrinë në motivet e saj historinë dhe ëndërrën shqiptare përmes artfjalës që në një mënyrë bart edhe përvojën e saj të idhët jetësore. Ajo është një krijuese e ndjenjës dhe sinqeritetit sepse sinqerisht e shpirtërisht i ishte përkushtuar dashurive të saj të mëdha. Përkushtimi i saj me plot devotshmëri por gjithmonë pa dashur të bie në sy, thuase e la në anonimitet, për ta rizbuluar pikërisht ky libër vjershash, këto poezi dhe vetë kthimi i saj në Kosovë, që paraqet edhe vazhdimësinë e pashkëputur të veprimtarisë së saj. Në këtë libër, autorja, dëshmon fuqishëm forcën e saj dhe pushtetin që ka mbi ndjenjat e veta, duke arritur suksesshëm që pikat më të rëndësishme të jetës së saj ti disiplinoj mes vargjesh e figurash, pa rënë në patetikë, por duke u shprehur në mënyrë të emancipuar për gjithë botën e saj të trondítur dhe ndonjëhere të humbur shpirtërore. Këtë e dëshmojnë poezitë "Lindja ime", "kthimi", "Vdes me trëndafilin", "Mikes sllovene" dhe poezitë kushtuar fëmijëve të saj dhe atyre të vendlindjes e që gjithësesi janë tjerë nga ata të vendeve në liri, sepse tjera ëndërra kanë ata. Autorja flet përmes gjuhës së figurave, duke arritur të krijoj një gjuhë të asociacionit dhe poezinë duke e ndërtuar me më pak fjalë, por me më shumë ndjesi dhe meditim. Përkundër që shpesh merret me motive të ashtuquajtura historike, ajo i ik folklorizmit me mjshtërinë e saj, i ik rrëfimit dhe e lë lexuesin në mesin e figurave dhe shqetësimit të saj poetik. Ky libër para së gjithash paraqet edhe arsyen e jetes së saj, duke treguar që imagjinata është ajo që e shpëton njeriun nga humbja në rrugën e vështirë jetësore. Libri në fjalë është një dëshirë e arsyes së të jetuarit dhe krijuarit të autores.

Qibrie Demiri'Frangu

KTHIMI

Lindja ime

Nga vrimë e gjilpërës
Kam lëshuar zënë
Për të parën herë
Për të qepur
Flamurin.

Plisin
Kam zbardhur
Duke skuqur bozhurin
Pafundësisht

Nga djepi
Ika maleve
Për të ngjallur
Arkivolin

Linda mbi re
Të ndjek pas
Mic Sokolin

Ninulat
I kisha tragjedi
Unë fëmija
Që mbaja gjallë
Të zezën nënë

Linda
Nga pranvera
Të ringjallem
Në dimër

Linda
Nga kënga
Të rroj në pikëllim

Në Kaçanik
Linda nga një hark
Ylberi
Të rroj e përjetshme si bijë
Shqipërie

Linda
Nga thinjat
Të rroj
Me lodra fëmijësh

Te një shtizë flamuri
Hodha shtat
Me akrepat e orës
Masja shekujt

Erdha e përjetshme
Sytë
Kurrë mos t'i mbyll
Linda nga hëna
Të vdes
Tek një yll

Kur binte telefoni

Gjithë dhembjet

Më përshkonin
Kur binte
Telefoni
Nga Kosova
Çdo të thoshin

E vranë e dogjën
Dhembjët e lindjes
S'i përballon dot
Kosovë
Ky ankth i imi
Nuk ishte
Vetëm një mot!

Poezía

Vetëm ti
Ma di shpirtin
Dhe atë pikën
Në zemër
Ti vjen si era
Ëndërrën ta takosh

Kufi për ty s'ka
Vjen si hije
Si shpirti
Vetëm ti e din
Si më gjen
Prushin ma sjell
Shpirtin
Ma mashtron
S'di nga vjen
Nga shkon

Krijon të palindurit
Rizgjon të parët
Merr udhët e udhëve
Të takosh
Dhembjen

Gjithëçka ke e s'ke
Çdo gjë mban e s'mban
Zjarrin
Për Kosovën
Në shuplak ma sjell.

Mbolle parullat

Njeriut të shkretit
I mbolle vdekjen
I hoqe jetën
Diktaturë moj

Pemës së jetës
I thithe lëngun
Shkule fidanët
Mbolle parullat

Si bishë
Te njerëzit
Ngjite trishtimin
Me xhaxhi Stalinin.

Shqipëria në ekran

Më vjen
Mbrëmjeve
Me këngët zëlarta
Më vjen
Si shpirti i lodhur
Si dita e Kosovës
Dhe më ngroh
Dimrin tim.

Vendlindjes

Në majë lapsi
Më rri
Asgjë tjetër të shkruaj
Nuk di
Të sjell në mendje

Bashkë
Me fëmijërinë
Kur haheshim
Me Serbinë

Sa thekshëm
Dëgjoj
Zërin tëndë
Edhe në gjumë
Lojën bëjë
Tek i yti
Lum.

Fëmijët e vendit tim

Ndryshe
Ëndërrojnë
Dhe
Hanë e pinë
Krejt
Ndryshe

Dhe mbathjet
I kanë ndryshe
Dhe dimrin
E presin
Me pak frikë
Ata
Janë ndryshe
Nga fëmijët
E tjerë
Edhe gurët
I shohin
Si bomba.

Qetësi

Më leni
Të qetë

Tek rri pranë një varri
Nuk është
Si varret e tjera

Pushoni pak,
Ju lutem
Po pres
Të vij një flutur
Në ajër
Me krah të bëjë
Fytyrën time
Derisa rri
Pranë këtij
Varri.

Do të kthehem

Do të kthehem
Ai gur ka vite
Që më thërret
Do të kthehem
Stalla e vjetër
Ëndërrën ma mban peng

Do të kthehem
Që njëmijë vjet
Më thërret lumi
Të më freskoj buzët
Shkrumb
Nga malli
Të më kthej letrën
E zverdhur
Me shkronjat e saj
Zemrën
E pata mbështjellur
Që t'mos
Ngrijë

Vetëm edhe pak
Ju lutem

Sa ta shoh dritën
Do të kthehem.

Rrezet

Mes mureve monotone
Rrezet e diellit
Thejnë
Heshtjen e vetmisë
Si babagjane
Hyn
Mes qelqit
Të dritares sime
Pa lule
Më kot mundohem
Ta përgëdhel
Shpresën
Se çelin
Trandafilat
Edhe
Në dritat e brishta
Eh sa herë
E murosi
Diku mendimin
E ndarjes

Kah eci

E vetme
Rreth lumit
Duke thurrur
Këngë dashurie
Për veten
Për fluturat
E di se më pret diku
Mes harqeve të ylberit
Shpresa ime
Me mashtrim
E ngjyrosur

Sërish më sfidon

Ndeshja me fatin

Rëndë më peshon malli
Fati
Me syt e korbit gjeloz
Më rrënon dritën
Dashuria
Sërish s'mu përgjigj
Sa here e pyeta
Si për inat
Ndërtonte heshtjen
Ti më pret
Me durimin copë - copë
E di
Tek ashti yt
Strehë do bëhem
Për sy
Tek mezhdë e arës
Tënde
Lulëkuqe
Do të mbijë
Gjithësesi
T'më kesh
Për zbukurim
Në dasmën tënde
Sa kam dëshirë
Të jem grimc guri
E diademit tënd
Dhe lulebore
Balsamosur
Në vellon tënde
Të kuqe.

KALENDARI I SHPIRTIT

Horizont

Nga maja e shkëmbit
Zgjata duart
Desha t'kapi
Detin
Ah ç'kënaqësi
Në detin e pakapshëm
Befas
Pulëbardha më qukiti dorën,
Më tërhoqi vërejtjen
Për ujin e trazuar
Pulëbardha
E dashura e ujërave.

Kaçanikasja

Rreth vetullës
Shaminë
Ke lidhur si në zi
Mos qoftë
Kob i yti
Me lotin e freskët
Në buzën qershi
Ty bijë dardane
Ç'mënxyrë
Të ka rënë në sy
Në pragun e derës
Pret
Zemrën e ke humbur
Diku
Fajson gurët
Lumin
Që si fëmijë qan
Gjëmë pret
Nga qielli
Retë mos prit të pushtojnë
Kaltërinë
Hidh krahut gjerdanit
Grykat

Le të gjallëojnë.

Rrugët

Monotone
Më është bërë
Ecja e vetmuar
Rrugëve të botës
Zëmadhe
Këmbët e rënduara
Sytë
Kërkojnë
Terrin
Që leht
Ta ndjejë mashtrimin
Preku kokën
Fytyrën
Trupin tim
Si një qytet
Të panjohur
E hulumtoj
Deri në zemër
A thua
Ç'kam ndryshuar
Nga kjo rrugë e gjatë
Mos stinët
Më vranë
Me dhembjet e tyre
Pa emër

Takimi me trishtimin e bukur

Deti pa mëshirë
Nxjerr të vjellurat
Nga thellësi e tij
E rëra
Peshë
Valët me shkumbëza
Shkëmbin

Joshin
Si me të puthura
Vështroj
Llahtarisht
Llahtaria nga liqeni
I lasgushit
Në detin tim është shtrirë
Sa here
Të tillë e shoh
Me trishtim takohem
Përqafohem
E ndjejë
Bukurinë e rrallë.

Sllovenja

Qetë
Si krah mjellme
Më shtrinë
Dorën
Si një copë zemre
Më lëshon shikimin

Mikesha ime
Sllovene
Më takon
Me mall rinie
Më rritë
Dashuri në zemer
Trishtimi
Bëhet hije

Të tre fëmijët e tu
Engjuj
Që rreth më rrinë
Nuk e dinë
Se në ta shoh
Lirinë
Që e duan fëmijët

E vendlindjes sime.

Lotët e dashurisë

Sllovene
Mikja ime
Lotët fshinë
Në faqe
Me një
Cepbuzëqeshjeje
Lutjen
për fëmijët e globit
e thotë
si për bukën.

Kosova në violinë

(*djalit Arbrit*)

Me dorën e vockël
Moxartin ringjall
Sonatë e Shopenit
Hap çdo petale

Salla
Plot arom muzike
Im bir
Luan Mazurkën
Paganinin trand
Që të tregoj shpirtin
E kosovës

Duartrokitjet
Për Kosovën
Në violinë
Sikur të mund t'i bëja
Drita lirie

Eh, Arbri im
Për plagën
E Kosovës

I vogël është
Ky kurim.

Ngjyrat e dashurisë

Ngjyrat e dashurisë
Nuk i ka
As piktura në mur
Atë nuk e pikturojnë
Asnjë pal duar

Ngjyrat e saj
Që netët t'i bëjnë ditë
Mund
Zemrën ta errësojnë
Kot i ke sytë.

Kalendari i shpirtit tim

Horizontet
Me ylbere coptuar
Mëngjeset
Me bar të qulltë
Janë varur në
Kalendarin e shpirtit tim
Çdo ditë
Dielli varet i përgjakur
Hëna zgërdhihet
Me dritën e saj naive
Në trurin tim
Vijëzoj me ngjyrë të kuqe
Tek ditë e fundit
E muajit
Kur ty të pashë.

Imagjinim

Me lot krijova
Lum
Lumi rrodhi

Në det
Atëherë
U ngrit vala
Sa se përpiu
Shkëmbin
Sa pata dëshirë
Të shihje
Se si shkumbëzat
I bëra zingjirë
Matan detit
I hudha
Desha të vij
Tek ti
Si në ëndërra
A thua
Në ëndërra
Të krijova edhe ty.

Eja

Sa me mall
Të vështroj
Se si ti mejton
Valë e detit
Më përpinë
Kur i heshtur
Pranë më kalon

Qiellin
Mbushur plot
Me yje
E vështroj
Për çdo natë
Një nga një i lidh
Nyje
Thurri shpresën
Gjatë-gjatë

Mjegull turbullja

Të vërboi
Ta besoj paqartësinë

Do të vish
Sa dielli s'shkoi
Shih pranverën
Shih kaltërinë.

Ngjyrím

Engjëllin
Këtu pranë
E ndjej
Në bebëzën
E dritës
Këndon këngën
E amshimit
Agmia e vesës
Buzët më njomëzon
Në një anë të qiellit
Shoh diellin duke lindur
Në anën tjetër
Zezona pushton
Zgjas duart
Nga qielli
Të kap një grusht
Rreze
Si kordelet e shpresës
Së copëzuar
Atëherë dielli
Më buzëqesh
Me dritën e trishtë
Mos u brengos
Më thotë
Edhe atje kam
Për t'ndriquar.

Ngjyra vjeshte

Vjeshta verdhomë
U shtri
Ngadal
Dhembshëm
Në faqen e tokës
Pjalm
Brymë kudo
Janë molisur lulet
Dhe bari i gjelbërt
Nga kopshti im
Iku bilbili
Është strukur
Diku si unë
Në zemrën tëndë
Në qoshet
E mërdhira
Duke m'i ngrirë edhe më
Dëshirat e mpira
Tek ngjyrë e verdhë
Dhe e kuqe
Gjen prehje e qetësi
Ah pranverë
E gjelbëruar
Kur do të takoj
Sërish ty
Me zemrën që më ka
Ndry.

PAGJUMËSI

Zgalem

Me ngjyrën e kaltërt
Hyra në thellësi të detit
Ndesha një yll magji
Me krahët e tij
Bëra krah zgalemi
Se ku u nisa

Se di

Dasmë në shtëpinë time

Tymi i ogjakut
E veçon sot
Shtëpinë time
Zjarre të mëdha
Po ndizen
Shtëpia është bërë
Lule
Orkide
Flamujt
Vocrrakë të gëzuar
Prekin qiellin
Nëpër podiume
Sot s'ka fjalime
Vajzat do t'i këndojnë
Dhëndërrit
E nuses
Si jetës
Tupanët
Do t'i kemi kushtrim
S'do kujtoj gjakun
Kënga sot.

Rreth Lublanicës

Qielli u përflak
Kush e di për të satën herë
Nga perëndimi i diellit
Yjet të përgjumur
Ende s'duken kund
Fllad i freskët mbrëmjeje
Më zhburoi mendjen
Tek po ecja
Rreth lumit fjalë shumë
Degët e shelgjeve

Si flokët e vashës
Përdredhur
Më miklojnë faqet
E zbehura si kjo ditë
Për një qast u ndala
Pranë shelgut
Malli rëndë
M'peshon në shpirt.

Pagjumësi

Tërë natën sonte
Hëna u zgërdhi
Me mua
E yjet lozin vallen e amshimit
Edhe mëngjesi
Sot më bënë dredhira
E nata kujtimet
S'do të m'i
Përgjumë.

Jam

Jam degë
Nga trungu i pemës
Shkëputur
Një gjethe
Nga rremi degës
Këputur
Një pikë lot i derdhur
Nga nëna e mjerë
Mall i nuses
Që pret në derë
Që pret një pranverë.

Në kuvlinë e mendimit

Kalova andejpari
Kur për të parën here
Zemra dithëroi

Si gjethi i pemës
Në flladin e pranverës
Kalova
Dhe pash copa ëndërrash
Si degë shelgu
Pas furtunës së vjeshtës
Atë natë
Hëna
Saq i skuqur ishte
Unë bëja luftë
Me dyshimin
Yjet tufë lulesh
Në dorën time
Përflaken nga dashuria
Të fluturoja doja
Si mendimi
Nga kuvli e errët truri
Të gozhdohem
Në horizont
Si lavëjerrës i orës
Prej druri.

Mirësia

Është në ty njeri
Që akullin e shkrinë
Me fjalën e pathënë

Është këngë
E shpirtit të ri
Të zgjatë jetën
Si luleja me magji

Mirësia
Bimë e shpirit
Të mirë
E bënë botën
Më të dlirë.

Takimi i fundit

Zemrat u dridhën
Nga ndjenjë e harlisur
Pa fjalë
Dhembja u ngjiz
Me lotin
Në buzë të përtharë
Fjalët e pathëna
Lëng bore
Në shikimet plot zjarr
Nuk e dita
Të besoj nuk deshta
Për erërat që frymojnë
Detrat ngrehin dallgë
Po ylberët
A ka kush i ndal.

Drejtësia

Unë
Nuk ta fala besimin
Ta firmosje diku
Mbi trupin tim
Hieroglifet
U ngjyrosën
Në zgavrat e syve të mi
Korbat
Mbijetojnë gjithmonë
Kudo rreth meje
Gjarpërojnë
Milingonat
Pirmidet murojnë
Faraonët ti varrosin
E kur ti të vish
Do të jem zhdukur
Tek asht i tokës
Ti

Varu dikund
Tek gjëmbat e trandafilave
Të egër.

Shoqërím

Një grusht kallinj
Në vazo
Mbi dritare i vura
Në dhomën time kube
Befas dritarja
Plot zoçka
U mbush
Matan qelqit çukitnin
Si në fushë
Në brishtësinë
E zemrës sime

Poeti mysafír

Kur poeti
Na erdhi në shtëpi
Çdo gjë skaj më skaj
Dha, ngjyrim të ri.

Erdhi poeti
Me të ëmbëlat thinja
Sendet ndër dhoma
Po rrinin si ndër rima.

Nëpër shtëpi
Tek më ndlej dora
Me majat e gishtave
Prekja metafora.

Vargjet e mia.
Pranë tij, sadopak
U tkurrën nga drojtja
Të rilindin prapë.

VDES ME TRËNFAFILIN

Unë e ti

Unë e ti -
Një zjarr, një stuhi
Unë e ti -
Një mall, një dashuri!
Unë e ti -
Një këngë, një tragjedi
Unë e ti....
..... Nuk e di!

Te bora sllovene

Pisha sllovene
Që nën borë kërrusen
Të bardha,
Të bardha ngjajnë tej hapësire
Herë si nuse Kosove
Herë kosovare nën qefin

E bardha
E pishave sllovene
Imazh i
Dramës sonë moderne

Episod Kosove

(*Vëllait Kadriut*)

Pranvera ra herët
Mbushën dritë rrugicat.
Pipthat e bajames
Ngrinin kokë mbi ngricat.

Dielli thuaj ngutej
Të ulej në oborre
S'dinte, që pas tij
Fshihej re dëbore

Befas zemra ngriu.
Ngrin dritë e pranveres.

Drejt shtëpisë na vinte
Një makinë plot njerëz.

Pse je zbehur bijë?
Më tha në ankth nëna-
Ç' mynxyrë Doruntinë
Të ka thënë ëndërra?

Gips i zi shih, nënë
Na vjen drejt shtëpie!
S'është kalë Konstandini
Është gips milicie.

Milicët hiena
Me gulqima kafshe
Hynë, kërko ndër mure
Ndër ahure kashte...

Rrëmbyen vëllain
Si një copë Kosove
-nëna ime e fortë
S'nxorri zë prej goje!

Fatí ím

...nëpër fildishët e bardhë
Të dhëmbëve
Më rridhte gjaku
Në cyrrela ylberi
E ata
Sa nuk pëlcitën
Kur gjakun gëlltita
Të mos e shihnit
Këmba e juaj
T'mos i shkelte
Ato pika...

Mall

Te ara e madhe
Pata mbjellur

Ëndërrën
Nga Lubjana ia ndjej
Zemërën

Është lodhur shumë
Bashkë
Me nënë time
Mbi baltë
T'i shoh gjurmët
- edhe një herë
Në jetën time!

Varri i Tivarit

Varri i Tivarit
Përjetë i hapur.
S'e mendonte as Dante
Kaq të përgjakur!

Varri i Tivarit
Eshtra e kafkë.
Sy, që përjetshëm
Rrinë hapur mbi plagë.

Gjaku i Tivarit,
Humnerë e pasosur
Atje të gjithë
Rrimë të varrosur...

Zhgënjím lulesh

Në erën e luleve
Si në qiellin e shtatë
Trimi e vasha
- luanin gjatë.

Zilia më zuri
Mu si rrëfe
Të kërkoja Ty
Të venim atje...
Atje ku na shihte

I vetëm bliri
Trupi e zemra
U bënë
Hark floriri

M'u binde
T'u binda
Seç shkreptinin
Ylberët nën blirë
Ti humbe në mjegull
Unë në errësirë.

Vdes me trëndafilin

Ka diçka timen
S'di si t'i them
Edhe mua në pranverë
Zemra më dhemb.

Disi kah vjeshta
Zemra më rrah
Shumë ndryshe
Verdhësia jote
Më pikëlon
Vjen sërish
Pastaj
Pranvera
Na
Rizgjon.
Vazhdojmë
Dashurinë
Bashkërisht
Unë e trëndafili

Pjesa ime e diellit

(*tim bir Besfortit*)

Më ndrin jetën
Si pjesë dielli je
Furtunat me ty

Shpirti im më pak ndje
Je ajo drita
Në mes të jetës sime
Emrit tënd sa shumë
I ngjanë
Më hap shtigjet
Nga çdo anë..

ص ص ص

PËRMBJTJA

KTHIMI

Parathënie
Lindja ime
Kur binte telefoni
Poezia
Mbolle parullat
Shqipëria në ekran
Vendlindjes
Fëmijët e vendit tim
Qetësi
Do të kthehem
Rrezet
Kah eci
Ndeshja me fatin

KALENDARI I SHPIRTIT

Horizont
Në kërkim
Kaçanikasja
Takim i bukur
Rrugët
Sllovenja
Lotët e dashurisë
Kosova në violinë
Ngjyrat e dashurisë
Kalendari i shpirtit
Imagjinimi
Eja
Ngjyrim
Ngjyra vjeshte

PAGJUMËSI

Zgalem
Dasëm në shtëpinë time
Rreth lublanicës
Pagjumësi
Jam
Në kuvlinë e mendimit
Mirësia
Takim i fundit
Drejtësi
Shoqërim
Poeti mysafir

VDES ME TRËNDAFILIN

Unë e ti
Te bora sllovene
Epizod kosove
Fati im
Mall
Varri i Tivarit
Zhgënjim lulesh
Vdes me trëndafilin
Pjesa ime e diellit

© *Pashtriku.org*